REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 166/26 Dt. 15.04.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-400 nr. 38941, datë 02.04.2026, të Rrahim Susurit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-400 nr. 38941, datë 02.04.2026, e Rrahim Susurit, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve lidhur me pjesëmarrjen e vajzës së tij, Riola Susurit, pianiste, në koncertin gala ''International Piano Ballkan Academy'', që do të mbahet me datë 17.04.2026 në Madrid të Spanjës, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve të pjesëmarrjes në këtë koncert, lejohen mjetet financiare në shumën prej 650,00 € (gjashtëqind e pesëdhjetë euro).

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.

3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

Për:

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.